

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiqi, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditëses L. L.-B. nga P., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), për shkak të anulimit të vendimit administrativ A dt....., duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.UZH.nr.160/2017 të datës 29.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditëses L. L.-B., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.UZH.nr.160/2017 të datës 29.08.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.UZH. nr.160/2017 e datës 29.08.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses L. L.-B., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Dep.administrativ, A.U.nr.1003/2013 dt.07.02.2017, për anulimin e vendimit të të paditurit-KPMSHCK A dt.....

Paditësja, kësaj gjykate në afat ligjor i ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën në tërësi e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës, me propozim që të aprovohet si e bazuar kërkesa, ndërsa aktgjykimi i kontestuar të anulohet, ose të aprovojë kërkesëpadinë e paditëse si të bazuar duke ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimeve të atakuar, kërkesës së paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses L. L.-B., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep.administrativ A.U.nr.1003/2013 dt.07.02.2017 me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditëses lidhur me anulimin e vendimit të të paditurit KPMSHCK A dt.....

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, ngase aktgjykimet e atakuara nuk janë përfshirë me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendon paditësja në kërkesë.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditëses në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, pretendon se nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe rrjedhimisht edhe Udhëzimi Administrativ i MSHP/DASHK nr.2003/05 të MSHP/DASHK, për procedurat ankimore të aplikueshëm sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, janë të zbatueshme si ligj special në raport me dispozitat e nenit 130 par.2 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe me këtë rast konsideron se janë shkelur parimet kryesore juridike. Konsideron se nuk është llogaritur saktë rrjedha e afatit pasi që sipas nenit 9.6 të këtij UA, parashihet zgjidhje tjetër në raport me LPA, me pretendim se komisioni ankimor duhet marrë vendim brenda afatit 60 ditësh kur rasti është referuar komisionit e jo datës së parashtrimit të ankesës.

Pretendimet e mësipërme të paditëses sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk qëndrojnë. Bazuar në nenin 130 pika 2 të LPA-së, del qartë se ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ. Kështu që edhe UA.nr.2003/05 i MSHP/DASHK, sipas vlerësimit të këtij kolegji rregullon këtë çështje në këtë drejtim ngase nuk mund të llogaritet rrjedha e afateve siç pretendon paditësja në kërkesë, sepse në momentin kur pala i drejtohet me ankesë organit administrativ duhet të konsiderohet si fillim i rrjedhës së afatit dhe kjo e drejtë nuk mund të jetë e pakufizuar në kohë. Në këtë drejtim edhe kjo gjykatë konsideron se data 01.12.2010, kur paditësja ka ushtruar ankesë ndaj njoftimit të së paditurës ka filluar të rrjedh afati prej 60 ditësh.

Gjithashtu, ky kolegji konsideron se pretendimet për shkeljen e parimeve në drejtësi se ligji special derogon ligjin e përgjithshëm dhe se ligji i mëvonshëm derogon ligjin e mëparshëm, janë të pabazuar ngase në rastin konkret konsideron se janë respektuar si LPA-ja, e po ashtu dhe UA kontestues si dhe ligji për shërbimin civil, sepse rrjedha e afatit ankimor për paditësen dhe mosveprimin i të paditurës drejtë është konstatuar në aktgjykimet e kontestuar të gjykatave të instancave më të ulëta janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Si më sipër, Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e paditëses janë të pabazuara, ngase aktgjykimet përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe se janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, se vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, se edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflike Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
ARJ.UZVP.nr.59/2017, më datë 30.10.2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit
Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi